

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

DEPARTAMENTI:TEKNOLOGJI USHQIMORE ME BIOTEKNOLOGJI

PROGRAMI: SHKENCA E USHQIMIT



“Evaluimi i numrit total të bakterieve dhe prevalenca e Listeria monocytogenes në akullore që shiten në markete të Prishtinës”

(Punim diplome në Master)

Mentore:

Prof. Ass. Dr. Rreze Gecaj

Kandidatja:

Marigona Musliu

Prishtinë, korrik, 2022

ABSTRAKTI

Ushqimi jo i sigurt rrezikon miliarda njerëz në botë. Shumë nga ta sëmuren e edhe vdesin. Sëmundjet e ndryshme me prejardhje nga ushqimi i kontaminuar vetëm po shtohen dita –ditës në botë.

Akullorja është një nga produktet e qumështit më të pëlqyera e më të konsumuara nga të gjitha moshat e sidomos fëmijët. Akullorja e kontaminuar është një rrezik potencial për popullatën. Si pasojë e praktikave të gabuara akullorja pëson rritje të numrit të mikrobeve që rezulton qoftë në përkeqësim të cilësisë ashtu edhe deri te helmimi i popullsisë. Ky studim i përket pikërisht kontaminimit të akullores me njërin nga patogjenët e shumë të ushqimor: *Listeria Monocytogenes*.

Studimi i bërë ka për qëllim të analizoj numrin total të bakterieve duke i kultivuar në Plate count agar (PCA), dhe të gjej përmes metodave molekulare dhe prevalencën e *Listeria monocytogenes* në akullore që shiten në markete të Prishtinës, me metodën e bazuar në ADN, reaksioni zinxhiror i polimerizimit ose PCR.

Disa nga akulloret e testuara në këtë studim kanë numër më të madh të lejuar të bakterieve totale për mostër. Përderisa numri i lejuar i bakterieve totale në akullore është deri 2 bakterie prezente për mostër, mostrat e analizuar me ID: MI vanillë me çokollatë , MI kornet çokollatë, L dredhëz, L vanilla, L çokollatë, A ylber në shklop, A kornet, A vanilla në shklop, LM banane, LM vanilla, LM çokollatë, N vanilla, N çokolladë, N kornet, C vishnje, C çokolladë, C kornet kanë kaluar këtë limit.

Të gjitha mostrat kanë treguar rritje efektive në mediumin pasurues dhe sasia e ADN-së së ekstraktuar sillet 46ng/µl -204ng/µl. Në total 18 mostra të akulloreve nga prodhues të ndryshëm janë marr në frigoriferet e marketeve në qytet dhe janë analizuar përmes metodës RT-PCR për praninë e *Listeria monocytogenes*.

Nga 18 mostra të testuara 6 nga to janë pozitive gjë që tregon për një gjendje mjaft shqetësuese për vendin tonë.

Disa nga akulloret e testuara kanë rezultuar pozitive për *Listeria Monocytogenes*. Nga të cilat tri lloje të akulloreve janë vendore dhe tri të tjera janë të importuara. Akulloret vendore të cilat kanë rezultuar pozitive janë me shije dredhëze, vanille, çokolladë, dhe me forma: kornet, shklop, dhe në gotë. Ndërsa tri akulloret e importuara janë me shije çokollade, vanille dhe me shije frutash, të gjitha janë në formë shkopi.

Fjalët kyçe: *Listeria monocytogenes*, akullore, ADN, PCR.